



## TEZË PROVIMI

### Moduli Dytë

“Kontrolli i brendshëm dhe Auditimi, Qeverisja, Menaxhimi i riskut dhe kontrollit”

27 Qershor 2026

### SEKSIONI 1- PYETJE ME ALTERNATIVA Çdo pyetje vlerësohet me 1(një) pikë

1. Sipas përkufizimit të IIA-së, auditimi i brendshëm ndihmon një entitet publik të arrijë objektivat e tij duke:
  - A. Hartuar buxhetin vjetor
  - B. Kryer inspektime financiare
  - C. **Sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes**
  - D. Hartuar pasqyrat financiare
2. Kush përfaqëson vijën e parë në Modelin me Tre Vija?
  - A. Auditimi i brendshëm
  - B. **Menaxherët dhe punonjësit që kryejnë aktivitetet e përditshme**
  - C. Kontrolli i Lartë i Shtetit
  - D. Komiteti i Auditimit
3. Një drejtori operative identifikon dhe trajton risqet e aktivitetit të saj. Sipas Modelit me Tre Vija, kjo drejtori përfaqëson:
  - A. **Vijën e parë**
  - B. Vijën e dytë
  - C. Vijën e tretë
  - D. Organin qeverisës
4. Përgjegjësia kryesore e vijës së parë në Modelin me tre vija është:
  - A. Dhënia e sigurisë së pavarur
  - B. Hartimi i standardeve të auditimit
  - C. **Identifikimi, vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve**
  - D. Kryerja e inspektimeve
5. Kontrolli i brendshëm është:
  - A. Një procedurë financiare
  - B. **Një proces dinamik integral që përshtatet vazhdimisht me ndryshimet**
  - C. Një inspektim periodik
  - D. Një raport vjetor
6. Cili nga më poshtë NUK është komponent i COSO-s?
  - A. Mjedisi i kontrollit
  - B. Monitorimi
  - C. Informacioni dhe komunikimi
  - D. **Auditimi i jashtëm**
7. Cili nga veprimet e mëposhtme do të cenonte pavarësinë e Auditimit të Brendshëm?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

- A. Vlerësimi i efektivitetit të kontrolleve.  
B. Rekomandimi i përmirësimeve të proceseve.  
**C. Miratimi i regjistrit të riskut dhe përcaktimi i oreksit për risk.**  
D. Kryerja e auditimit të bazuar në risk.
8. Një auditues i brendshëm pranon të hartojë procedurat e kontrollit të brendshëm dhe më pas planifikon auditimin e tyre. Cili parim cenohet?  
A. Transparenca  
**B. Pavarësia dhe objektiviteti**  
C. Efektiviteti  
D. Përgjegjshmëria
9. Vlerësimi i rrezikut është:  
**A. Identifikimi dhe analiza e rreziqeve për arritjen e objektivave**  
B. Auditimi i pasqyrave financiare  
C. Kontrolli i inventarit  
D. Hartimi i buxhetit
10. Tre shtyllat e KBFP janë:  
A. Buxheti, Thesari dhe Kontabiliteti  
**B. MFK, Auditimi i Brendshëm dhe NJQH**  
C. Auditimi i Jashtëm, Inspektimi dhe Prokurimi  
D. COSO, INTOSAI dhe IIA
11. Një institucion identifikon risqet çdo vit, por nuk i përditëson ato kur ndryshojnë objektivat. Cila fazë e menaxhimit të riskut është më e dobët?  
A. Identifikimi  
B. Komunikimi  
**C. Rishikimi dhe monitorimi**  
D. Trajtimi i riskut
12. Sipas IIA, mashtrimi është:  
A. Një gabim i paqëllimshëm  
B. Një veprim i karakterizuar nga pakujdesia  
**C. Çdo akt i qëllimshëm i karakterizuar nga mashtrimi, fshehja, pandershmëria ose përvetësimi i paligjshëm**  
D. Vetëm korrupsion
13. Cili kontroll do të konsiderohej më efektiv për të reduktuar riskun e vetëvlerësimit në Auditimin e Brendshëm?  
A. Rritja e numrit të audituesve.  
**B. Auditimi të kryhet nga një auditues që nuk ka marrë pjesë në projektimin e procesit.**  
C. Rritja e frekuencës së auditimeve.  
D. Rritja e dokumentacionit të punës.
14. Cili komponent i COSO-s siguron që informacioni i nevojshëm të arrijë tek personat e duhur në kohën e duhur?  
A. Mjedisi i kontrollit  
**B. Informacioni dhe komunikimi**  
C. Monitorimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

- D. Aktivitetet e kontrollit
15. Një risk me probabilitet të lartë dhe ndikim të lartë duhet të trajtohet si:
- A. Risk i lartë
  - B. Risk mesatar
  - C. Risk kritik**
  - D. Risk i pranueshëm

**SEKSIONI 2- PYETJE ME SHTJELLIM**      *Secila pyetje vlerësohet me 5(pesë) pikë*

**1. Shpjegoni si auditimi i brendshëm ndihmon një entitet publik të arrijë objektivat e tij.**

**Përgjigje:**

Ndihmon një entitet publik të arrijë objektivat e tij duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes.

Me anë të një qasje të disiplinuar, AB do të ndihmojë menaxhmentin në vlerësimin dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e operacioneve të tij.

**2. Në modelin me tre vija, përshkruani rolet dhe përgjegjësitë e vijës së parë.**

**Përgjigje:**

Vija e Parë – Menaxhimi Operacional

- Kush janë? Menaxherët dhe punonjësit që kryejnë aktivitetet e përditshme.
- Roli: Përgjegjës për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve.
- Kontrolli: Zbatojnë kontrolle të brendshme për të siguruar përputhshmëri me politikat.

**3. Renditni dhe shpjegoni pesë komponentët e Kornizës COSO.**

**Përgjigje:**

Korniza COSO për kontrollin e brendshëm përbëhet nga pesë komponentë të ndërlidhur:

- A. mjedisi i kontrollit
- B. vlerësimin e rrezikut
- C. aktivitete kontrolli
- D. informacion dhe komunikim
- E. monitorim.”

Këta pesë komponentë bazë dhe grupimi i tyre ofrojnë një kombinim të kontrolleve "të buta", siç është krijimi i një mjedisi në të cilin kontrolli i brendshëm mund të funksionojë dhe të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

lulëzojë, së bashku me lloje më të rrepta dhe më tradicionale të kontrolleve "të forta" mbi transaksionet kontabël dhe financiare.

- 4. Një institucion publik ka identifikuar risqet kryesore, por nuk ka përcaktuar "pronarët/përgjegjësit" e riskut dhe nuk monitoron zbatimin e masave. Analizoni pasojat për efektivitetin e sistemit të menaxhimit të riskut.**

#### **Përgjigje e sugjeruar**

Një sistem efektiv i menaxhimit të riskut nuk përfundon me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Ai kërkon gjithashtu përcaktimin e përgjegjësive për administrimin e secilit risk, zbatimin e masave të trajtimit dhe monitorimin e vazhdueshëm të efektivitetit të tyre. Mungesa e përgjegjësive të riskut dhe e monitorimit tregon se procesi i menaxhimit të riskut nuk është i plotë dhe nuk funksionon në mënyrë efektive. Kur nuk përcaktohet një person ose strukturë përgjegjëse për administrimin e një risku, nuk ka përgjegjësi të qartë për zbatimin e masave të trajtimit, monitorimin e tyre dhe raportimin e rezultateve.

Një dobësi tjetër lidhet me mungesën e monitorimit. Menaxhimi i riskut është një proces i vazhdueshëm dhe jo një aktivitet që kryhet vetëm një herë në vit. Pa monitorim periodik, institucioni nuk është në gjendje të vlerësojë nëse risqet kanë ndryshuar, nëse kontrollet e vendosura funksionojnë siç duhet dhe nëse masat e trajtimit kanë reduktuar ekspozimin ndaj riskut. Për pasojë, risqet mund të materializohen pa u ndërmarrë në kohë masat korrigjuese.

Këto mangësi ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e vendimmarrjes. Drejtuesit nuk marrin informacion të besueshëm dhe të përditësuar mbi statusin e risqeve, mbi efektivitetin e masave të trajtimit dhe mbi ekspozimin aktual të institucionit. Në mungesë të këtij informacioni, vendimet strategjike dhe operacionale nuk bazohen në analizën e riskut, duke rritur mundësinë për vendime joefektive ose joekonomike.

Një pasojë tjetër është rritja e riskut të mbetur. Edhe nëse janë planifikuar masa kontrolli, mungesa e përgjegjësive dhe e monitorimit bën që ato të mos zbatohen ose të mos japin rezultatet e pritshme. Pra mungesa e pronarëve/përgjegjësve të riskut dhe e monitorimit cenon komponentin Vlerësimi i Riskut dhe komponentin Monitorimi të modelit COSO, pasi organizata nuk arrin të sigurojë që risqet identifikohen, trajtohen dhe rishikohen në mënyrë të vazhdueshme.

- 5. Etika konsiderohet një nga elementët themelorë të qeverisjes së mirë dhe i mjedisit të kontrollit sipas modelit COSO. Analizoni rëndësinë e etikës në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe shpjegoni se si mungesa e kulturës etike mund të ndikojë në menaxhimin e riskut, efektivitetin e kontrolleve dhe arritjen e objektivave të institucionit.**

#### **Përgjigje e sugjeruar**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Etika përfaqëson grupin e vlerave, parimeve dhe standardeve të sjelljes që udhëheqin veprimtarinë e drejtuesve dhe punonjësve të një organizate. Në sektorin publik, etika është një element thelbësor për garantimin e integritetit, transparencës, paanshmërisë dhe llogaridhënies në administrimin e burimeve publike. Një organizatë mund të ketë procedura të detajuara dhe kontrole të mirëprojektuara, por në mungesë të një kulture etike ato kontrole mund të anashkalojnë ose të zbatohen vetëm formalisht.

Sipas modelit COSO, etika është pjesë e **Mjedisit të Kontrollit**, i cili përbën bazën e të gjithë sistemit të kontrollit të brendshëm. Integriteti dhe vlerat etike të drejtuesve ndikojnë drejtpërdrejt në kulturën organizative dhe në mënyrën se si punonjësit i perceptojnë përgjegjësitë e tyre. Kur drejtuesit respektojnë ligjin, procedurat dhe standardet etike, ata krijojnë një kulturë ku kontrolli i brendshëm shihet si një mjet për arritjen e objektivave dhe jo si një detyrim formal.

Në të kundërt, nëse drejtuesit tolerojnë shkeljet, favorizojnë individë të caktuar ose anashkalojnë procedurat, punonjësit krijojnë perceptimin se rregullat nuk zbatohen në mënyrë të barabartë. Kjo ul motivimin për respektimin e kontroleve, rrit mundësinë e mashtrimit dhe korrupsionit dhe dobëson besimin në institucion. Një organizatë me kulturë të fortë etike karakterizohet nga:

- respektimi i Kodit të Etikës dhe i legjislacionit;
- shembulli pozitiv i drejtuesve ("tone at the top");
- trajtimi i barabartë i punonjësve;
- mekanizma të besueshëm për raportimin e parregullsive;
- reagimi i menjëhershëm ndaj shkeljeve etike;
- trajnime periodike mbi etikën dhe integritetin.

Për të forcuar kulturën etike, drejtuesit duhet të demonstrojnë integritet në vendimmarrje, të zbatojnë në mënyrë të barabartë rregullat për të gjithë punonjësit, të promovojnë transparencën dhe llogaridhënien, si dhe të sigurojnë që çdo shkelje të trajtohet në mënyrë objektive dhe të dokumentuar. Organizata duhet të zhvillojë trajnime të vazhdueshme mbi etikën, të përditësojë Kodin e Etikës dhe të krijojë kanale të sigurta për raportimin e shkeljeve.

### **SEKSIONI 3- USHTRIME** *Secila pyetje vlerësohet me nga 6(gjashtë) pikë*

#### **Ushtrimi 1**

Një institucion publik po zbaton një projekt investimi për ndërtimin e një godine administrative. Gjatë auditimit evidentohen këto mangësi:

- nuk është hartuar regjistri i riskut për projektin;
- projekti është rishikuar katër herë gjatë zbatimit pa një analizë të dokumentuar të risqeve;
- afatet e realizimit janë shtyrë disa herë;
- kostoja e projektit është rritur me 20%;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

- drejtuesit nuk kryejnë monitorim periodik të ecurisë së projektit dhe nuk analizojnë devijimet nga plani fillestar.

**Kërkohet**

1. Identifikoni tre risqe kryesore që paraqiten në këtë situatë.(2 pikë)
2. Duke u bazuar në informacionin e dhënë, argumentoni cili risk paraqet ekspozimin më të lartë për institucionin. (1 pikë)
3. Propozoni tre masa kontrolli që do të reduktonin risqet e identifikuar dhe shpjegoni si kontribuon secila prej tyre në përmirësimin e menaxhimit të projektit. (3 pikë)

**Zgjidhje e sugjeruar**

**1. Risqet kryesore**

Risku	Arsyetimi
<b>Tejkalimi i kostove të projektit</b>	Ndryshimet e shpeshta dhe mungesa e analizës së riskut kanë sjellë rritje të kostove, duke cenuar përdorimin ekonomik të fondeve publike.
<b>Mosrealizimi i projektit brenda afateve</b>	Mungesa e monitorimit dhe rishikimet e vazhdueshme rrisin probabilitetin e vonesave në përfundimin e projektit.
<b>Mosarritja e objektivave të projektit</b>	Dobësitë në planifikim, monitorim dhe menaxhim të riskut mund të bëjnë që projekti të mos realizojë rezultatet e planifikuara për institucionin.

(Kandidati mund të identifikojë edhe risqe të tjera, si cilësia e dobët e punimeve, risk reputacional ose risk ligjor, nëse i argumenton.)

**2. Risku me ekspozimin më të lartë**

Në bazë të informacionit të dhënë, risku me ekspozimin më të lartë është mosrealizimi i objektivave të projektit, pasi ai përfshin dhe materializon pasojat e risqeve të tjera. Tejkalimi i kostove dhe vonesat janë tashmë të dukshme, por ndikimi më i madh është rreziku që investimi të mos përmbushë qëllimin për të cilin është financuar, duke cenuar efektivitetin e përdorimit të fondeve publike për shkak të mungesës së planifikimit dhe monitorimit efektiv.

**3. Masat e kontrollit**

Masa e kontrollit	Kontributi në reduktimin e riskut
<b>Hartimi dhe përditësimi periodik i regjistrimit të riskut</b>	Mundëson identifikimin, analizimin dhe trajtimin sistematik të risqeve gjatë gjithë ciklit të projektit.
<b>Monitorimi periodik i projektit dhe analiza e devijimeve nga plani</b>	Evidenton në kohë problemet që lidhen me kostot, afatet dhe cilësinë, duke mundësuar ndërhyrje korrigjuese para materializimit të plotë të riskut.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Masa e kontrollit	Kontributi në reduktimin e riskut
Vendosja e një procedure formale për miratimin e ndryshimeve në projekt	Siguron që çdo ndryshim të bazohet në analizë teknike, financiare dhe të riskut, duke kufizuar ndryshimet e pajustificuara dhe tejkalimin e kostove.

### Ushtrimi 2

Një organizatë ka vendosur procedura për autorizimin e pagesave dhe verifikimin e dokumentacionit para kryerjes së tyre.

#### Kërkohet:

Identifikoni komponentin COSO dhe shpjegoni qëllimin e tij.

#### **Përgjigje**

#### Aktivitetet e kontrollit

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat që ndihmojnë në sigurimin e zbatimit të direktivave të menaxhimit. Ato ndihmojnë në sigurimin e ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme për të adresuar rreziqet që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të njësisë. Aktivitetet e kontrollit ndodhin në të gjithë njësinë publike, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha funksionet. Ato përfshijnë një gamë aktiviteteve që larmishme sa miratimet, autorizimet, verifikimet, pajtimet, rishikimet e performancës operative, siguria e aseteve dhe ndarja e detyrave.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë uljen e rreziqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e organizatës dhe që ndihmojnë në zbatimin e vendimeve të menaxherëve

### Ushtrimi 3

Grupi rreziqet e mëposhtme sipas kategorive përkatëse në tabelë:

Nr.	Lista e rreziqeve	Përzgjidhni kategorinë: <ul style="list-style-type: none"><li>• Rreziqet e jashtme</li><li>• Rreziqet operationale</li><li>• Rreziqet e ndryshimit</li></ul>
1	Ligjore;	
2	Politike;	
3	Politika të reja;	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

4	Kapaciteti dhe aftësia;	
5	Projekte të reja;	
6	Socio-kulturore;	
7	Ndrysho programet;	
8	Ekonomike;	
9	Teknologjike;	
10	Dërgim;	

**Përgjigje:**

Nr.	Lista e rreziqeve	Përzgjidhni kategorinë: • Rreziqet e jashtme • Rreziqet operacionale • Rreziqet e ndryshimit
1	Ligjore;	Rreziqet e jashtme
2	Politike;	Rreziqet e jashtme
3	Politika të reja;	Rreziqet e ndryshimit
4	Kapaciteti dhe aftësia;	Rreziqet operacionale
5	Projekte të reja;	Rreziqet e ndryshimit
6	Socio-kulturore;	Rreziqet e jashtme
7	Ndrysho programet;	Rreziqet e ndryshimit
8	Ekonomike;	Rreziqet e jashtme
9	Teknologjike;	Rreziqet e jashtme
10	Dërgim;	Rreziqet operacionale

**Ushtrimi 4**

Plotësoni tabelën e mëposhtme duke evidentuar rolin e auditimit të brendshëm:

F. Rolet kryesore të auditimit të brendshëm në lidhje me Menaxhimin Riskut

G. Role legjitime të IA-së me masa mbrojtëse

H. Rolet që auditimi i brendshëm NUK duhet t'i ndërmarrë.

për situatat e më poshtme:

Nr.	Situata	Roli i auditimit të brendshëm
-----	---------	-------------------------------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

		A, B ose C
1	Dhënia e sigurisë mbi proceset e menaxhimit të riskut.	
2	Përcaktimi i oreksit për rrezik.	
3	Mirëmbajtja dhe zhvillimi i kornizës së Menaxhimit të Riskut të Ndërmarrjes (ERM).	
4	Zhvillimi i strategjisë së menaxhimit të riskut për miratimin e bordit	
5	Rishikimi i menaxhimit të rreziqeve kryesore	
6	Përgjegjësia për menaxhimin e riskut	
7	Imponimi i proceseve të menaxhimit të riskut.	
8	Duke dhënë siguri se rreziqet vlerësohen saktë.	
9	Vlerësimi i raportimit të rreziqeve kryesore.	
10	Koordinimi i aktiviteteve të ERM-së.	

**Zgjidhje**

Nr.	Situata	Roli i auditimit të brendshëm A, B ose C
1	Dhënia e sigurisë mbi proceset e menaxhimit të riskut.	A
2	Përcaktimi i oreksit për rrezik.	C
3	Mirëmbajtja dhe zhvillimi i kornizës së Menaxhimit të Riskut të Ndërmarrjes (ERM).	B
4	Zhvillimi i strategjisë së menaxhimit të riskut për miratimin e bordit	B
5	Rishikimi i menaxhimit të rreziqeve kryesore	A
6	Përgjegjësia për menaxhimin e riskut	C
7	Imponimi i proceseve të menaxhimit të riskut.	C
8	Duke dhënë siguri se rreziqet vlerësohen saktë.	A
9	Vlerësimi i raportimit të rreziqeve kryesore.	A
10	Koordinimi i aktiviteteve të ERM-së.	B

**Ushtrimi 5**

Gjatë një auditimi në një institucion publik konstatohet se:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

- një proces me risk të lartë nuk është audituar gjatë pesë viteve të fundit;
- drejtuesit nuk kryejnë monitorim periodik të efektivitetit të kontrolleve;
- nuk dokumentohen rishikime të procedurave dhe nuk analizohen ndryshimet në profilin e riskut;
- rekomandimet e mëparshme nuk ndiqen dhe nuk raportohet mbi statusin e zbatimit të tyre.

**Kërkohet**

1. Identifikoni dobësinë kryesore të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Shpjegoni cili komponent i modelit COSO është prekur dhe argumentoni përgjigjen tuaj. (2 pikë)
2. Propozoni katër masa për përmirësimin e monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. (4 pikë)

**Zgjidhje e sugjeruar**

1. Problemi kryesor është **mungesa e një procesi efektiv monitorimi të sistemit të kontrollit të brendshëm**. Institucioni nuk kryen monitorim të vazhdueshëm nga menaxhimi dhe nuk realizon vlerësime periodike të pavarura të efektivitetit të kontrolleve. Për pasojë, dobësitë e sistemit nuk identifikohen dhe nuk korrigjohen në kohë. **Komponenti COSO** më i prekur është **Monitorimi**. Sipas modelit COSO, monitorimi siguron që sistemi i kontrollit të brendshëm të vazhdojë të funksionojë në mënyrë efektive dhe të përshtatet me ndryshimet në objektivat, proceset dhe risqet e institucionit. Në rastin konkret mungojnë të dy mekanizmat e monitorimit:

**monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimet e ndara**, pasi drejtuesit nuk analizojnë funksionimin e kontrolleve, nuk ndjekin zbatimin e rekomandimeve, procesi nuk është audituar për një periudhë të gjatë, atëherë organizata nuk ka siguri nëse kontrollet ekzistuese vazhdojnë të jenë efektive dhe se risqet nuk janë rritur/ndryshuar me kalimin e kohës.

**3. Rekomandime**

Masa e rekomanduar	Kontributi në përmirësimin e sistemit
Përfshirja e procesit në planin vjetor të auditimit bazuar në risk	Siguron një vlerësim të pavarur të efektivitetit të kontrolleve dhe identifikimin e dobësive që kërkojnë përmirësim.
Vendosja e monitorimit periodik nga menaxhimi	Drejtuesit duhet të analizojnë rregullisht funksionimin e kontrolleve, performancën e procesit dhe devijimet nga objektivat.
Rishikimi periodik i procedurave dhe regjistrin të riskut	Siguron që kontrollet të përditësohen në përputhje me ndryshimet në aktivitet, teknologji dhe profilin e riskut.
Krijimi i një sistemi për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit	Mundëson monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, përcaktimin e përgjegjësive dhe raportimin periodik tek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Masa e rekomanduar	Kontributi në përmirësimin e sistemit
	drejtuesit.
<b>Përcaktimi i treguesve të monitorimit</b>	Lejon matjen objektive të efektivitetit të kontrolleve dhe identifikimin e hershëm të dobësive.

**SEKSIONI 4 - RASTE STUDIMI** *Secila pyetje vlerësohet me nga 10(Dhjetë) pikë*

**Rast Studimor 1**

Ministria po rishikon strukturën e saj organizative për të përmirësuar qeverisjen dhe menaxhimin e riskut. Ministria ka një staf prej 500 punonjësish, një Sekretar të Përgjithshëm, 6 Drejtorë të Përgjithshëm dhe një Njësi të Auditimit të Brendshëm me 5 auditues. Organi qeverisës kërkon që të sigurohet llogaridhënie, transparencë dhe menaxhim efektiv i riskut.

**Kërkesa:** Bazuar në Modelin me Tre Vija, identifikoni rolet përkatëse për secilën vijë në këtë ministri.

**Përgjigje**

**Vija e Parë – Menaxhimi Operacional:** “Menaxherët dhe punonjësit që kryejnë aktivitetet e përditshme. Roli: Përgjegjës për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve. Kontrolli: Zbatojnë kontrolle të brendshme për të siguruar përputhshmëri me politikat.”

Në këtë rast, stafi prej 500 punonjësish dhe Drejtorët e Përgjithshëm përfaqësojnë vijën e parë, duke zbatuar kontrollet në aktivitetet e përditshme.

**Vija e Dytë – Funkcionet e Menaxhimit të Rrezikut dhe Pajtuëshmërisë:** “Njësi të specializuara si menaxhimi i rrezikut, pajtuëshmëria, kontrolli financiar. Roli: Mbikëqyrin vijën e parë dhe ndihmojnë në zhvillimin e politikave. Kontrolli: Sigurojnë që kontrollet janë të përshtatshme dhe funksionojnë siç duhet.”

Sekretari i Përgjithshëm dhe strukturat e menaxhimit financiar e pajtuëshmërisë përfaqësojnë vijën e dytë, duke mbikëqyrur dhe monitoruar vijën e parë.

**Vija e Tretë – Auditimi i Brendshëm:** “Auditorët e brendshëm, të pavarur nga aktivitetet operacionale. Roli: Ofron siguri të pavarur dhe objektive për efektivitetin e menaxhimit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

rrezikut. Kontrolli: Vlerëson punën e dy vijave të para dhe raporton te bordi ose komiteti i auditimit.”

Njësia e Auditimit të Brendshëm me 5 auditues përfaqëson vijën e tretë, duke ofruar siguri të pavarur dhe objektive mbi efektivitetin e qeverisjes dhe menaxhimit të riskut.

### Rast Studimor 2

Në një procedurë prokurimi, i njëjti specialist harton specifikimet teknike, merr pjesë në komisionin e vlerësimit të ofertave dhe monitoron zbatimin e kontratës. Audituesi konstaton gjithashtu se nuk ekziston një kontroll i pavarur mbi këtë proces.

### Kërkohet

1. Vlerësoni nëse sistemi i kontrollit të brendshëm në këtë proces mund të konsiderohet i besueshëm. Arsyejtoni. (2 pikë)
2. Nëse menaxhimi pretendon se mungesa e stafit justifikon përqendrimin e funksioneve, a jeni dakord? (2 pikë)
3. Cilat parime të kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes janë cenuar dhe cilat janë pasojat për institucionin? (3 pikë)
4. Cili do të ishte opinionin juaj si auditues dhe cilat masa do të rekomandonit me prioritet? (3 pikë)

### Përgjigje e sugjeruar

Bazuar në faktet e paraqitura, **sistemi i kontrollit të brendshëm nuk mund të konsiderohet i besueshëm**, pasi një nga parimet themelore të kontrollit të brendshëm – **ndarja e detyrave** është cenuar në mënyrë të konsiderueshme. Përqendrimi i funksioneve të hartimit të specifikimeve teknike, vlerësimit të ofertave dhe monitorimit të zbatimit të kontratës tek i njëjti specialist eliminon mekanizmat e kontrollit të ndërsjellë dhe rrit ndjeshëm mundësinë që gabimet ose parregullsitë të mos identifikohen në kohë. Nuk mund të pranohet argumenti i menaxhimit se mungesa e stafit justifikon përqendrimin e këtyre funksioneve tek një person. Kufizimet në burimet njerëzore mund të krijojnë vështirësi organizative, por nuk e përjashtojnë menaxhimin nga përgjegjësia për funksionimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm. Nëse ndarja e plotë e detyrave nuk është e mundur, menaxhimi duhet të projektojë **kontrolle kompensuese**, si rishikimi dhe miratimi nga një nivel më i lartë drejtues, mbikëqyrja e pavarur, rishikimet periodike ose kontrolle të tjera që reduktojnë riskun.

**Situata cenon disa parime themelore të kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes.** Së pari, cenohet parimi i ndarjes së detyrave, pasi i njëjti individ ushtron funksione që duhet të kontrollojnë njëra-tjetrën. Së dyti, dobësohet llogaridhënia, sepse mungon një kontroll i pavarur mbi vendimmarrjen. Së treti, preken parimet e transparencës, objektivitetit dhe integritetit, të cilat janë thelbësore në administrimin e procedurave të prokurimit publik. Nga këndvështrimi i modelit COSO, dobësia prek kryesisht komponentin Aktivitetet e Kontrollit, por ndikon edhe në Mjedisin e Kontrollit, pasi tregon se menaxhimi ka pranuar një organizim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

që nuk garanton kontroll të mjaftueshëm. Po ashtu, cenohen edhe Monitorimi dhe Informacioni dhe Komunikimi, pasi mungon një mekanizëm i pavarur që të verifikojë në mënyrë objektive funksionimin e procesit.

**Pasojat për institucionin janë të shumta.** Përqendrimi i funksioneve rrit riskun e konfliktit të interesit, favorizimit të operatorëve ekonomikë, mashtrimit dhe korrupsionit. Gjithashtu, rritet mundësia për gabime në hartimin e specifikimeve teknike, në vlerësimin e ofertave ose në monitorimin e kontratës, të cilat mund të mos evidentohen për shkak të mungesës së kontrollit të ndërsjellë. Nëse këto risqe materializohen, institucioni mund të përballet me pasoja financiare, ligjore dhe reputacionale, si dhe me cenimin e besimit të publikut në integritetin e procesit të prokurimit.

Në cilësinë e audituesit përgjegjës të misionit, do të konkludoja se sistemi i kontrollit të brendshëm për këtë proces **nuk ofron siguri të arsyeshme** për ligjshmërinë, rregullsinë dhe integritetin e procedurës së prokurimit. Dobësia kryesore nuk lidhet vetëm me mungesën e ndarjes së detyrave, por edhe me mungesën e mekanizmave kompensues që do të reduktonin riskun e përqendrimit të kompetencave. **Rekomandimet prioritare do të ishin:** ndarja e funksioneve të hartimit të specifikimeve teknike, vlerësimit të ofertave dhe monitorimit të kontratës ndërmjet personave ose strukturave të ndryshme; vendosja e kontroleve kompensuese në rastet kur ndarja e plotë nuk është e mundur; rishikimi dhe miratimi i pavarur i vendimeve kryesore të procedurës; deklarimi dhe verifikimi i konfliktit të interesit për të gjithë personat e përfshirë në proces; dokumentimi i plotë i çdo faze të procedurës për të garantuar gjurmueshmëri dhe transparencë; si dhe monitorimi periodik i procedurave të prokurimit nga menaxhimi dhe Auditimi i Brendshëm për të identifikuar dhe korrigjuar dobësitë sistematike.

### Rasti Studimor 3

Një agjenci qeveritare po vlerësohet nga audituesit e brendshëm për proceset e qeverisjes. Agjencia ka një Bord Drejtues me 7 anëtarë, një Drejtor Ekzekutiv, dhe 4 departamente. Gjatë auditimit, u vërejt se mbledhjet e Bordit nuk zhvillohen rregullisht, nuk ka një Kod të Sjelljes të miratuar, dhe raportimi financiar është i vonuar.

#### Kërkesat:

- a) Bazuar në parimet e qeverisjes së mirë të IIA-s, identifikoni tre probleme kryesore në këtë agjenci.
- b) Sipas rolit të auditimit të brendshëm në qeverisje, shpjegoni si mund të ndihmojë auditimi në përmirësimin e këtyre proceseve.

#### Përgjigje:

- a) 3 problemet kryesore të identikuara:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

KOMISIONI I KUALIFIKIMIT TË AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

- I. Mungesa e strukturave dhe proceseve të përshtatshme për qeverisje efektive: Mbledhjet e Bordit nuk zhvillohen rregullisht, duke treguar mungesë të mbikëqyrjes efektive.
- II. Mungesa e promovimit të vlerave dhe sjelljes etike: Nuk ka një Kod të Sjelljes të miratuar, duke treguar mungesë të angazhimit ndaj integritetit dhe vlerave etike.
- III. Informacion dhe vendime jo transparente: Raportimi financiar është i vonuar, duke treguar mungesë të informacionit cilësor për vendimmarrje.

b) Roli i auditimit të brendshëm në përmirësimin e proceseve:

Auditimi i brendshëm mbështet përgjegjësitë e qeverisjes si mbikëqyrës, si vlerësues i brendshëm dhe si parashikues.

**Si mbikëqyrës:** Audituesit ndihmojnë vendimmarrësit në kryerjen e mbikëqyrjes duke vlerësuar nëse organizata po bën atë që pritet prej saj. Në këtë rast, ata mund të vlerësojnë nëse Bordi po kryen funksionet e tij siç duhet.

**Si vlerësues i brendshëm:** Auditorët ofrojnë vlerësime nga brenda organizatës për të mbështetur vendimmarrësit duke vlerësuar se cilat politika po funksionojnë dhe cilat jo. Ata mund të vlerësojnë efektivitetin e strukturave ekzistuese të qeverisjes.

**Si parashikues:** Auditorët ndihmojnë organizatën të shohë përpara duke identifikuar trendet dhe duke sjellë në vëmendje problemet urgjente përpara se ato të shndërrohen në kriza.